



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 696/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Florije Krasniqi-Pireva, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për deputet Sejdi Hoxha, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara apelet Anr.696/2021, Anr.697/2021, Anr.698/2021, Anr.699/2021, Anr.700/2021, Anr.701/2021 Anr.702/2021, Anr.703/2021, Anr.704/2021, Anr.705/2021, Anr.706/2021, Anr.707/2021, Anr.708/2021, Anr.709/2021, Anr.710/2021, Anr.711/2021, Anr.712/2021, të datës 05.03.2021, të paraqitura nga kandidati për deputet Sejdi Hoxha, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), paraqitur kundër vendimit me numër 860-2021 të dt.04.03.2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shpalljen e rezultatit përfundimtar,

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar apelet me numër Anr.696/2021, Anr.697/2021, Anr.698/2021, Anr.699/2021, Anr.700/2021, Anr.701/2021 Anr.702/2021, Anr.703/2021, Anr.704/2021, Anr.705/2021, Anr.706/2021, Anr.707/2021, Anr.708/2021, Anr.709/2021, Anr.710/2021, Anr.711/2021, Anr.712/2021, të datës 05.03.2021, të paraqitura nga kandidati për deputet Sejdi Hoxha, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Në apelet e parashtruara kandidati për deputet Sejdi Hoxha, me numër rendor 35, pretendon se në Vendvotimet: 0317E-01R, 0317E/03D, 0317E/02R, 0310E/03D, 0310E/02R, 0306E/01R, 0310E/01R, 0313E/03D, 0319E/01R, 0319E/02R, 0306E/02R, 0306E/03R, 0313E/02R, 0304E/01R, 0304E/02D, 0306E/04D, dhe 0313E/01R, komisionerët nuk i kanë përshkruar drejtë votat në Formularin e Rezultateve për Kandidat-FRP-ve, duke konstatuar jo saktë gjendjen faktike, gjegjësisht numrin e votave, duke vepruar në kundërshtim me nenin 5, 57, 59, 64 dhe 89 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme-LZP.

Si dëshmi në apele ka bashkangjitur deklaratat e tij të mbështetura në pretendimet e familjarëve dhe miqve, se të njëjtit e kanë votuar më 14.02.2021.

Parashtruesi i apeleve ka kërkuar nga PZAP-i që të bëjë rinumërimin e fletëvotimeve në vendvotimet e përshkruara në apel.

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me Anr.696/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për 17 apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apelet janë të pabazuara

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos regjistrim-shënim të votave gjatë numërimit të fletëvotimeve, për faktin se thënie e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë të imagjinuara sepse pritet e apellesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e apellesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, Paneli vlerësoi se apelet e parashtruara nga kandidati për deputet Sejdi Hoxha, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), nuk janë të bazuara në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave me kusht dhe atyre me postë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.696/2019 më datën 06.03.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.